



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:244229

Datë: 28.02.2025

Numri i dokumentit: 06923580

**C.nr.126/12**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm** Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj, në çështjen juridike të Paditësve D.K.nga fshati D., Komuna Malishevës, A.K.nga fshati D., Komuna e Malishevës, A.K.nga fshati D., Komuna Malishevës, ndaj të paditurës Ekonomia e Pyjeve në Malishevë, lidhur me vërtetimin e pronësisë në paluajtshmëri dhe dorëzimin e saj, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 28.02.2025 morri këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.** Procedura në këtë çështje juridike kontestimore **NDËRPRITET** për shkak të vdekjes së të paditurit D.K.nga ish fshati Ll.D., Komuna e Malishevës.

**II.** Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të paditurit e marrin përsipër procedurën apo kur të njëjtit i thërret gjykata që të bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

**A r s y e t i m**

Paditësit D.K., A.K.dhe A.K., të përfaqësuar sipas autorizimit nga D.K., me datë 21.08.2012, ka parashtruar padi, pranë kësaj gjykate lidhur vërtetimin e pronësisë në paluajtshmëri dhe dorëzimin e saj, ndaj të paditurës Ekonomia e Pyjeve në M.. Mirëpo me Aktvendimin C.nr.126/12 të datës 12.03.2018 kjo padi është konsideruar si e tërhequr.

I autorizuari i paditësve me datë 18.10.2021, ka deponuar parashtrësën me të cilën kërkon që të vazhdohet procedura në lëndën civile C.nr.126/12 të datës 21.08.2012 dhe njoftoi gjykatën se kjo lëndë është regjistruar në këtë gjykatë me datë 21.08.2012, janë mbajtur disa seanca por që një kohë të gjatë më nuk është proceduar kjo lëndë. Propozojnë që të vazhdohet procedura në këtë lëndë civile.

Me datë 26.02.2025 familjari i të ndjerit gojarisht ka njoftuar gjykatën se i ndjeri D.K.ka vdekur me datë 30.03.2023 dhe si provë gjykatës ia ka dorëzuar certifikatën e vdekjes me numër rendor ... dhe referencë .... të datës 26.02.2025.

Gjykata pas shqyrtimit të certifikatës së vdekjes si më lart, gjeti se i paditësi D.K.ka vdekur me datë 30.03.2023 në Malishevë, andaj duke marrë parasysh këtë fakt, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi bazuar në nenin 277 pika (a) të Ligjit Procedurës Kontestimore.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil**  
**C.nr.126/12, me dt. 28.02.2025**

Gjyqtari  
Nehat Qelaj

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesë në afat prej 15 ditësh, pas ditës së marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.